



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

---

Numri i lëndës: 2020:028196

Datë: 22.05.2024

Numri i dokumentit: 05721045

Ac.nr.2256/2022

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Naim Mehollli, kryetar i kolegjit, Burim Shala dhe Liridon Maloku, anëtar të kolegjit, në çështjen juridike të paditëses M.U. nga fsh....., Komuna e Gj....., të cilën me autorizim e përfaqëson Malsore Halili avokate nga Vitia, kundër të paditurës Komuna e Gjilanit, të cilën me autorizim e përfaqëson Burim Maliqi nga Gjilani, Zyrtar i Lartë Ligjor në Zyren e Avokatit të Komunës, për shkak të shpenzimeve të ushqimit, dhe shpërblimit jubilar, duke vendosur lidhur me ankesën e të paditurës, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjilan-Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.452/2020, të datës 25.01.2022, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 22.05.2024 mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

REFUZOHET e pathemeltë ankesa e të paditurës Komuna e Gjilanit - Drejtoria Komunale e Arsimit, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjilan-Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.452/2020, të datës 25.01.2022, VËRTETOHET.

**A r s y e t i m**

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e ankimuar C.nr.452/2020, të datës 25.01.2022, ka vendosur si në vijim: **I.Aprovohet** si e bazuar me ligj, kërkesëpadia e paditëses M.U. nga fsh....., Komuna e Gj..... dhe detyrohet e paditura Komuna e Gjilanit, që paditëses, t'ia paguajë shumën e të hollave në lartësi prej 315,75 euro, në emër të shpërblimit jubilar për 20 vite përvojë pune në vlerë të 75% të një page baze, në emër të kompensimit të shujtave të ushqimit, për periudhën kohore nga data 18.04.2017 e deri me datën 10.03.2020, respektivisht për 423 ditë të pranisë në punë, shumën e të hollave në lartësi prej 846.00 euro, respektivisht shumën e përgjithshme prej 1,161.75 euro, duke e llogaritur kamatën prej 8% në vit, nga data 25.02.2020/ data e ushtrimit të padisë/ e deri në pagesën definitive, të gjitha në afat prej 7 ditë pas ditës së pranimit të këtij Aktgjykimi, nën pasojat e përmbarrimit të dhunshëm ligjor.

**II. Detyrohet** e paditura Komuna e Gjilanit, që paditëses t'ia kompensoj shpenzimet e procedurës kontestimore në lartësi prej 270.00 €, në afat prej 7 ditë, pas ditës së pranimit të këtij Aktgjykimi.

Kundër këtij aktgjykimi brenda afatit ligjor ka paraqitur ankesë, e paditura përmes të autorizuarit të saj, për shkak të shkeljes thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe për shkak të zbatimit të gabuar të

së drejtës materiale, me propozim që Gjykata e Apelit, ta aprovoj si të bazuar ankesën e të paditurës, ta anulojë aktgjykimin e atakuar si të pabazuar dhe çështjen ta kthen ne rigjykim ose që ta refuzojë si të pabazuar kërkesëpadinë e paditëses.

Përgjigje në ankesë nuk ka paraqitur paditësja.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 195 dhe 200 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

Ankesa e të paditurës është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedhë se paditësja, përmes përfaqësuesit së tij, në këtë gjykatë ka ushtruar padi ndaj të paditurës Komuna e Gjilanit, ndërsa në parashtresën e datës 18.01.2022 dhe në shqyrtimin gjyqësor të mbajtur më datën 25.01.2022 e ka ndryshuar padinë dhe kërkesëpadinë në aspektin objektiv, ashtu që ka kërkuar nga gjykata që detyrohet e paditura që paditësit, t'ia paguajë, shumen e të hollave në lartësi prej 315.75 euro, në emër te shpërblimit jubilar për 20 vite përvojë pune në vlerë të 75% të pages bazë, pastaj në emër të kompensimit të shujtave të ushqimit, për periudhën kohore nga data 18.04.2017 e deri me datën 10.03.2020, respektivisht për 423 ditë të pranisë në punë, shumën e të hollave në lartësi prej 846.00€ , respektivisht shumën e përgjithshme prej 1,161.75 euro, duke e llogaritur kamatën prej 8% në vit, nga data 25.02.2020 data e ushtrimit të padisë/ e deri në pagesën definitive, të gjitha në afat prej 7 ditë pas ditës së pranimit të këtij Aktgjykimi, nën pasojat e përmbarimit të dhunshëm ligjor si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë së paditësit dhe precizimit të saj, pas shqyrtimit të çështjes në seancën e shqyrtimit kryesor ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar C.nr.452/2020, me datë 25.01.2022, me të cilin e ka aprovuar në tërësi kërkesëpadinë e paditëses, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar.

Në arsyetim të aktgjykimit gjykata e shkallës së parë pas vlerësimit të provave të administruara, erdhi në përfundim se kërkesëpadija e paditëses është e bazuar dhe vendosi si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar, pasi që në mes të palëve ndërgjyqëse nuk është kontestues fakti se paditësja është e punësuar si mësimdhënëse në SHFMU "I....." në fshatin Bresalc, Komuna e Gjilanit, ngase një fakt të tillë e konfirmon edhe Vërtetimi nr.25/2020 i datës 10.02.2020 i lëshuar nga kjo shkollë ku e njëjta ka përvojë pune 22 vite e 5 muaj përvojë pune, poashtu nuk është kontestues fakti se e njëjta me kërkesë në procedurë administative i është drejtuar Komunës së Gjilanit-Drejtorisë Arsimit në Gjilan për kompensimin e pagës jubilarë, pagesës së ushqimit, por kontestuese për gjykatën ka qenë kompetenca lëndore, pastaj fakti nëse Kontrata Kolektive e Arsimit prodhon efekte juridike pasi që e njëjta nuk është në fuqi. Në bazë të Vërtetimit nr.87/2020 i dt.07.09.2020, Gjykata ka vërtetuar faktin se paditësja për periudhën kohore nga data 18.04.2017 e deri me datë 10.03.2020 ka qenë e pranishme në punë për 423 ditë, ashtu që konform nenit 35 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, e paditura duhet t'ia kompenzoj shpenzimet e ushqimit ditor nga dy/2/ euro në ditë, respektivisht shumën në lartësi prej 1846 euro. Poashtu në bazë të Listës së pagave të lëshuar nga Buxheti i Republikës së Kosovës shihet se paditësja pagën bruto e ka 521,46 euro kurse neto e ka 421.00 euro dhe ka përvojë pune mbi 22 vite, ashtu që konform nenit 35 paragrafi 8 pika 8.2 i Kontratës Kolektive të Arsimit të njëjtës i takon kompensimi i shpërblimit jubilar për mbi 20 vite përvojë pune në vlerë të 75% të një page bazë apo shuma e të hollave në lartësi prej 315,75 euro. Lidhur me pretendimet e të paditurës gjykata arsyeton se është e kompetencës lëndore për të gjykuar rastin, pasi që sipas dispozitave ligjore të Ligjit për Gjykatat e Rregullta/ Ligjinr. 06/L – 054 në nenin 12.1 decidivisht është përcaktuar se „Gjykatat Themelore janë

*kompetente për të gjykuar në shkallë të parë të gjitha çështjet, përpos nëse me ligj parashihet ndryshe.* Kurse Departamenti për Qështje Administrative në kuadër të Gjykatës Themelore në Prishtinë, sipas nenit 17 të Ligjit për Gjykatat gjykon qështjet administrative, respektivisht gjykon sipas padisë për hapjen e konfliktin administrativ, kur kemi një vendim administrativ të formës së prerë ndaj të cilit pala e pakënaqur ushtron padi me qëllim të realizimit të së drejtës së tij subjektive apo kur kemi të bëjmë me heshtje të administratës dhe për kategoritë e punëtorve që sipas nenit 4 të Ligjit mbi Shërbimin Civil të Kosovës/ Ligji Nr. 03/L-149/ mardhënia juridike e të cilëve rregullohet me këtë Ligj, të cilët sipas nenit 82 të Ligjit ndjekin procedurën e realizimit të së drejtës së tyre së pari në Komisionin për Ankesa dhe Parashtrësia, pastaj i drejtohen Këshillit të Pavarur Mbikqyrës e mëpastaj me padi i drejtohen Gjykatës Themelore në Prishtinë -Departamentit për Qështje Administrative për hapjen e Konfliktit Administrativ, kurs siq dihet të punësuarve në sektorin e arsimit ju garantohet mbrojtje ligjore konform Ligjit të Punës së Kosovës. Gjykata poashtu konstaton se e paditura qëndron në detyrimin ndaj paditëses edhe pse nuk është nënshkruese e Kontratës Kolektive të Arsimit/Kontrata nr.24. e datës 18.04.2017/, pasi që në nenin 2 të Kontratës është përcaktuar se kjo kontratë është e zbatueshme edhe për komunat apo DKA-të. Po ashtu për gjykatën është i pabazuar edhe pretendimi tjetër i të paditurës ku ka cekur se Kontrata Kolektive e Arsimit të Kosovës nuk prodhon efekt për të paditurën, dhe e njëjta ka skaduar, ngase një pretendim i tillë është në kundërshtim me Ligjin për Arsimin në Komunitet e Republikës së Kosovës me nr.03L-068, ku në nenin 35 pikat 5, 7 dhe 8 të këtij ligji janë të parapara kompetencat e komunave sa i përket punësimit të mësimitdhënësve dhe drejtorëve si dhe pagesës së tyre, e rrjedhimisht edhe detyrimet e parapara me Kontratë bien në barrë të paditurës.

Detyrimi i të paditurës për pagesën e kamatës dhe kamatëvonesës prej 8% në vit është gjykuar nga Gjykata konformnenit 382 të LMD/ Ligjinr. 04/L-077 i datës 10 maj 2012, në të cilën dispozitë është përcaktuar se „ *Debitori që vonon në përmbushjen e detyrimit në të holla debitorin, përpos borxhit kryesor, edhe kamatën. 2. Lartësia e kamatëvonesës është tetë përqind (8%) në vit, përveç nëse parashihet ndryshe me ligj të veçantë.*

Sa i përket bazës ligjore gjykata vendimin e saj e ka bazuar në nenin 35, paragrafi 7 dhe 8 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë / *Kontrata nr. 24 e dt. 18.04.2017/* ngase në nenin përkatës në mënyrë shprehimore është përcaktuar se: *Punëtorët (antarë të SBASHKUT-ut) në vitin jubilar të punësimit përfitojnë shpërblimin jubilar nga punëdhënsi i fundit, në vlerë: për 10 vite të përvojës së punës shpërblimin 50% të një page bazë, për 20 vite të përvojës së punës shpërblimin 75% të një page bazë, për 30 vite të përvojës së punës shpërblimin në vlerë të një page bazë... kurse në bazë të nenit 35 paragrafi 7 të Kontratës në mënyrë shprehimore është përcaktuar se „*të punësuarve, u sigurohet kompensim për ushqim gjatë punës, për ditët e pranisë në punë. Vlera e kompensimit të shpenzimit të ushqimit në punë, për një ditë pune është dy /2/ € për të punësuarit që kanë mardhënien e punës primare në institucionet arsimore.**

Gjykata e Apelit e aprovon vlerësimin juridik të gjykatës të shkallës së parë si të rregullt dhe të ligjshëm sa i përket vendosjes si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, të pretenduara dhe as në shkeljet nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m), të LPK-së, dhe rrjedhimisht nuk ka aplikim të gabuar të drejtës materiale për të cilat gjykata kujdeset sipas detyrës zyrtare.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore e të autorizuarit të paditurës se aktgjykimi është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika n) e LPK-së. Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, dispozitivi i aktgjykimit të atakuar është mjaft i qartë, e në përputhje të plotë me arsyet e aktgjykimit, duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike me arsyetimin. Gjykata ka arsyetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për themelësinë e kërkesëpadisë e në lidhshmëri me këtë ka arsyetuar mënyrën se si janë

vërtetuar faktet përveç atyre jo kontestuese e gjithashtu edhe mënyrën se si i ka vlerësuar provat për secilin fakt të provuar.

Gjykata e Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë në këtë procedurë kontestimore drejtë e ka vërtetuar gjendjen faktike pasi që pasi që nuk është kontestues fakti se paditësja është Mësimdhënës i mësimit lëndor në SHFMU “I.....” fsh..., Gj....., ngase një fakt të tillë e konfirmon Vërtetimi me nr.prot.25/2020 të datës 10.02.2020, ku vërtetohet se paditësi ka (22) e dy vite, 5 muaj përvojë të punës, e poashtu nuk është kontestues fakti se e njëjta me kërkesë në procedurë administrative i është drejtuar Komunes së Gjilanit-Drejtorisë së Arsimit në Gjilan për kompensimin e pagës jubilarë, pagesës së ushqimit, por kontestuese është kompetenca lëndore e gjykatës, pastaj fakti nëse Kontrata Kolektive e Arsimit prodhon efekte juridike, pasi që e njëjta nuk është në fuqi dhe nuk është nënshkruar nga e paditura, si dhe parashkrimi i kërkesës sa i përket shpërblimit jubilar. Në bazë të vërtetimit me nr. 87/2020 të datës 07.09.2020, gjykata vërteton se paditësja për periudhën kohore nga data 18.04.2017 e deri me datë 10.03.2020 ka qenë e pranishëm në punë për 423 ditë, ashtu që konform nenit 35 paragrafi 7 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, e paditura duhet t’ia kompenzoj shpenzimet e ushqimit ditor nga dy/2/ euro në ditë, respektivisht shumë në lartësi prej 846.00 €, Në bazë të listës së pagave të lëshuara nga Ministria e Financave e Republikës së Kosovës, gjykata vërtetoi faktin se paditësi pagën bazë e ka 421.00 € dhe ka përvojë pune 20 vite dhe të njëjtit i takon kompensimi i 75 % page bazë në shumë prej 315.75 €, konform nenit 35 paragrafi 8 te kontratës së lartcekur.

Lidhur me pretendimin e zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, kjo gjykatë vlerësoi se gjykata e shkallës së parë në rastin konkret në mënyrë të drejtë e ka zbatuar të drejtën materiale.

Me nenin 90 të Ligjit të Punës, është paraparë se: “1.Marrëveshja Kolektive mund të lidhet ndërmjet: 1.1. organizatës së punëdhënësve ose përfaqësuesit të tij, dhe 1.2. organizatës së të punësuarve ose kur nuk ekzistojnë organizata, marrëveshjen mund ta lidhin edhe përfaqësuesit e të punësuarve; 2. Marrëveshja Kolektive mund të lidhet në:2.1. nivel të vendit,2.2. nivel të degës,2.3. nivel të ndërmarrjes; 3. Marrëveshja Kolektive duhet të jetë në formë të shkruar, në gjuhët zyrtare të Republikës së Kosovës; 4. Marrëveshja Kolektive mund të lidhet për një periudhë të caktuar me kohëzgjatje jo më shumë se tri (3) vjet. 5. Marrëveshja Kolektive vlen për ata punëdhënës dhe punëmarrës të cilët marrin përsipër detyrimet e përcaktuara me Marrëveshjen e tillë Kolektive. 6. Marrëveshja Kolektive nuk mund të përfshijë dispozita të tilla që kufizojnë të drejtat e të punësuarve që kanë si pasojë kushte më pak të favorshme të punës sesa ato të përcaktuar në këtë ligj”, ndërsa me nenin 4, paragrafi 2 të po këtij ligji, është paraparë se: “Kontrata Kolektive nuk mund të përmbajë të drejta më pak të favorshme për të punësuarin dhe punëdhënësin se sa të drejtat e përcaktuara me këtë ligj”.

Sipas nenit 35, paragrafi 7 të KKA-së është paraparë se: “Të punësuarve, u sigurohet kompensim për ushqim gjatë punës, për ditët e pranisë në punë. Vlera e kompensimit të shpenzimit të ushqimit në punë, për një ditë pune, është 2 (dy) euro për të punësuarit që kanë marrëdhënien e punës primare në institucionet arsimore. Punëdhënësi, i cili e ka të rregulluar ushqimin e të punësuarve, përmes restaurantit a kuzhinës, ose në një formë tjetër, nuk ka obligim kompensimin e ushqimit” kurse sipas nenit 35, pika 8. të kësaj Kontrate, është përcaktuar qartë se “Punëtorët (anëtarët e SBASHK-ut) në vitet jubilarë të punësimit përfitojnë shpërblimin jubilar nga punëdhënësi i fundit në vlerë prej: për 20 vite të përvojës së punës në vlerë të 75 % të një page bazë”, ndërsa me pikën 8.5 të po këtij neni parashihet se: “Shpërblimi jubilar paguhet nga punëdhënësi, kur i punësuarin i ka plotësuar kushtet e shpërblimit sipas kriterëve përkatëse

Gjykata e shkallës së parë me rastin e aprovimit të kërkesëpadisë së paditëses e ka detyruar të paditurën që paditëses t'ia paguaj shumën e kompensimit për ushqim, dhe atë bazuar në nenin 35 par.7 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, në të cilin nen ndër të tjera thuhet se: "...Të punësuarve, u sigurohet kompensim për ushqim gjatë punës, për ditët e pranisë në punë. Vlera e kompensimit të shpenzimit të ushqimit në punë, për një ditë pune, është 2 (dy) euro për të punësuarit që kanë marrëdhënien e punës primare në institucionet arsimore...", andaj, lidhur me pretendimet ankimore të paditurës, për kompensimin e udhëtimit dhe shujtave ditore, Gjykata e Apelit i vlerësoj si pretendimet të pabazuara dhe pa ndikim për vendosje ndryshe në kontestin në fjalë, për të njëjtat shkaqe vlerësoj se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar dhe aktgjykimi i atakuar vlerësohet si rregullt dhe i drejtë.

Nga interpretimi i këtyre dispozitave ligjore, Gjykata e Apelit erdhi në përfundim se gjykata e shkallës së parë drejtë ka vërtetuar se në këtë rast ekziston detyrimi juridiko - civil, ndaj paditësit në emër të pagesës për kompensimin e shpërblimit jubilar, shpenzimet e rrugës si dhe shpenzimeve të ushqimit – shujtës gjatë ditëve të pranisë në punë, për arsye se me nenin 245 paragraf 1 të LMD-së, përcaktohet se: "Kreditori në marrëdhënien e detyrimit ka të drejtë që prej debitorit të kërkoj përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë ta përmbush atë me ndërgjegje dhe në tërësi, në përputhje me përmbajtjen e tij".

Në raport me pretendimin ankimor të paditurës se kontrata kolektive në të cilën është thirr paditësja dhe gjykata, se kjo kontratë është në kundërshtim me Ligjin e Punës dhe se Komuna e Gjilanit si punëdhënëse e paditësit nuk është nënshkruese e kësaj Kontrate kolektive, Gjykata e Apelit e refuzon si të pa bazuar një pretendim të tillë për shkak se me nenin 90 par.4 të Ligjit të Punës nr.03/L-212 në të cilin nen ndër të tjera thuhet se: "... Marrëveshja Kolektive mund të lidhet për një periudhë të caktuar me kohëzgjatje jo më shumë se tri (3) vjet...", ndërsa në nenin 2 par.1.2 të Kontratës Kolektive e Arsimit në Kosovë të datës 18.04.2017, ndër të tjera thuhet se: "Dispozitat e kësaj Kontrate Kolektive janë të zbatueshme për të gjithë punëdhënësit në sektorin e Arsimit, (Komunat- DKA, KD të Universiteteve e institucioneve të arsimit të lartë, MASHT-in etj.) në sektorin publik dhe institucionet edukativo-arsimore private në mbarë territorin e Republikës së Kosovës...", ndaj detyrimi për zbatimin e kësaj kontrate ka fuqinë ligjore.

Gjykata e Apelit lidhur me afatshmërinë e padisë, vlerësoi se kërkesa e paditëses nuk është parashkruar, për shkak se, në bazë të nenit 87 të Ligjit të Punës, me nr. 03/L-212 i datës 01.11.2010, përcaktohet se: "Të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës **në para** parashkruhen brenda afatit prej 3 - vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës " duke u bazuar në këtë dispozitë ligjore dhe e cila ishte në fuqi në kohën e krijimit të raportit juridik, rrjedh se padia e paditëses është e lejuar dhe e ushtruar brenda afatit kohor.

Vendimi sa i përket kamatës nga gjykata e shkallës së parë është në përputhje të plotë me dispozitën nga neni 382 të LMD-së.Vendimi mbi shpenzimet e procedurës është në përputhje me dispozitën nga neni 452.1 të LPK-së, ndërsa veprimet e ndërmarra në këtë çështje juridike kontestuese janë arsyetuar drejtë, në përputhje me tarifën për përcaktimin e lartësisë së shpenzimeve dhe në pajtim me dispozitat e LPK-së.

Janë vlerësuar edhe pretendimet tjera ankimore, por Gjykata e Apelit nuk ka gjetur se aktgjykimi i atakuar është i përfshirë në ndonjë shkelje, prandaj të gjitha pretendimet janë vlerësuar si të pabazuara.

Nga të lartë cekurat e në mbështetje të dispozitës së nenit 194 dhe 195.1 pika d), lidhur me nenin 200 të LPK-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Numri i lëndës: 2020:028196  
Datë: 22.05.2024  
Numri i dokumentit: 05721045

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË  
Ac.nr.2256/2022, me datë 22.05.2024

Kryetari i kolegjit  
Naim Mehulli, d.v